



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr.983/2 Prot.

Tiranë, më 02.11.2023

V E N D I M

Nr. 91, datë 02.11.2023

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil, në ngarkim të ish “Sekretarit të Përgjithshëm” dhe paralajmërimin e institucionit Autoriteti i Konkurrencës për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit , pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të procesit të verifikimit të informacionit të administruar përmes shkresave me nr. 846 prot., datë 29.08.2023, nr. 846/1 prot., datë 08.09.2023 dhe nr. 999 prot., datë 17.10.2023, pranë Komisionerit,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacionit të dërguar nga një nëpunës civil, regjistruar me shkresat nr. 846 prot., datë 29.08.2023, nr. 846/1 prot., datë 08.09.2023 dhe nr. 999 prot., datë 17.10.2023, Komisioneri është njohur me faktin se, procedura disiplinore e njoftuar me shkresën nr. 359/3 prot., datë 29.06.2023, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, e nisur në ngarkim të ish “Sekretarit të Përgjithshëm”, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, vijon të jetë në proces.

Konstatohet se. Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 359/31 prot., datë 21.08.2023, ka njoftuar nëpunësen ***** , më parë e ngarkuar me detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, pranë këtij institucioni dhe ndërkohë e pezulluar nga shërbimi civil, se Komisioni i Disiplinës i ngritur me urdhrin nr. 359/1 prot., datë 27.06.2023, i ndryshuar, me qëllim ndjekjen e procedurave të ecurisë disiplinore në ngarkim të kësaj nëpunëse, ka vendosur ta njoftojë atë se pretendimet/prapësimet, do të dëgjohen në mbledhjen e tij, të datës 08.09.2023, ora 10.00.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nëpunësja ***** me shkresën e datës 07.09.2023, me objekt: *“Kthim përgjigje shkresës nr. 359/31, datë 21.08.2023, të Autoritetit të Konkurrencës”*, i është drejtuar institucionit Autoriteti i Konkurrencës dhe për dijeni njësisë përgjegjëse pranë këtij institucioni, duke parashtruar të gjitha shkeljet e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, të pretenduara prej saj, të ndodhura gjatë procedurës së ndjekur nga Komisioni Disiplinor, si dhe të evidentuara në përmbajtje të akteve të prodhuara gjatë ecurisë disiplinore, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve të kryera nga ky Komision, deri në këtë moment, si dhe anulimin e akteve të prodhuara gjatë këtij procesi disiplinor.

Në vijim, Komisioni i Disiplinës referuar procesverbalit nr. 359/38 prot., datë 08.09.2023, është mbledhur në këtë datë, në mungesë të nëpunëses në procedim disiplinor dhe ka marrë në shqyrtim informacionin e përpiluar nga nëpunësit ***** dhe *****, në të cilin evidentohet moskryerje e detyrave nga nëpunësja ***** gjatë ushtrimit të detyrës së *“Sekretarit të Përgjithshëm”*, pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Referuar përmbajtjes së këtij procesverbali, citohet se:

*“Rezulton e faktuar që ***** ka firmosur vetëm pas ftesës së Autoritetit dhe me shumë vonesë vlerësimet e punës së stafit për 6 mujorin e dytë 2022, ndërkohë nuk ka firmosur dokumentacionin lidhur me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje autoveturë e re”. Komisioni vlerëson që këto përbëjnë gjithashtu shkelje disiplinore shumë të rënda, të cilat do të merren parasysht. Komisioni vendosi për datën 14.09.2023 për t’u mbledhur”.*

Më tej, sipas përmbajtjes së procesverbalit nr. 359/46 prot., datë 28.09.2023, Komisioni i Disiplinës është mbledhur në këtë datë, ka marrë edhe një herë në shqyrtim mospërmbushjen e detyrave të përmendura në informacionin e administruar, në mbledhjen e datës 08.09.2023 dhe ka konstatuar se, bazuar në nenin 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, mosrealizimi i detyrave të cituara në paragrafin më sipër, përbën shkelje të rëndë dhe shumë të rëndë, si rrjedhim, në mbështetje të nenit 58, germa ç), ka vendosur *largimin nga shërbimi civil për punonjësen *****.*

Mbështetur në konkluzionin e arritur në mbledhjen e datës 28.09.2023, Komisioni i Disiplinës me Vendimin nr. 1 (nr. 359/47 prot.), datë 28.09.2023 ka vendosur dhënien e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për punonjësen *****.

Ky vendim i është njoftuar nëpunëses me shkresën nr. 359/48 prot., datë 06.10.2023, *“Përcjellim vendimin”*, të Sekretarit të Përgjithshëm, të komanduar, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Sa i takon fakteve të referuara më sipër, nëpunësja *****, përmes shkresave nr. 846 prot., datë 29.08.2023 dhe nr. 846/1 prot., datë 08.09.2023, dërguar Komisionerit, ka pretenduar fillimisht parregullsi në drejtim të zhvillimit të procesit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, që kanë dalë përpara se të merrej masa disiplinore.

Më tej, nëpërmjet shkresës së protokolluar me nr. 999 prot., datë 17.10.2023, nëpunësja në fjalë, ka informuar Komisionerin për një masë disiplinore që është aplikuar ndaj saj, duke pretenduar se Vendimi nr. 1, (nr. 359/47 prot.), datë 28.09.2023, i Komisionit Disiplinor, i cili në këtë rast materializon edhe masën disiplinore largim nga shërbimi civil, është një akt që ka dalë në kushtet e pavlefshmërisë absolute dhe në kundërshtim me vendimmarrjet e mëparshme të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil duke renditur edhe disa arsye për të mbështetur pretendimet e saj.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me informacionet e dërguara për këtë rast, ka marrë masa për të verifikuar vërtetësinë e tyre, në drejtim të parregullsive në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit për të kryer veprime të caktuara procedurale gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil. Nëpërmjet shkresës nr. 983 prot., datë 10.10.2023, me objekt: “*Kërkesë për verifikimin e informacionit të administruar pranë Komisionerit përmes shkresës nr. 846 prot., datë 29.08.2023 dhe shkresës nr. 846/1 prot., datë 08.09.2023*”, është kërkuar kopja e plotë e dokumentacionit që materializon ecurinë e procesit disiplinor të nisur në ngarkim të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, i cili aktualisht është i pezulluar nga shërbimi civil.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, institucioni i Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 359/51 prot., datë 16.10.2023, “*Kthim përgjigje shkresës tuaj nr. 983 prot., datë 10.10.2023*”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 983/1 prot., datë 18.10.2023, në vijim të dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, të evidentuar ne procesverbalin nr. 359/14 prot., datë 12.07.2023, përcolli edhe një pjesë tjetër të dokumentacionit në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur.

Sjellim në vëmendje në këtë moment se, procedura e ndjekur dhe aktet e nxjerra nga nëpunësit e ngarkuar prej ligjit me detyra specifike gjatë zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore, si dhe dinamika me të cilën ka ndryshuar marrëdhënia e punësimit pranë Autoritetit të Konkurrencës për nëpunësen *****, kanë qenë edhe më parë, objekt verifikimi dhe inspektimi nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Në përfundim të këtyre proceseve, Komisioneri është shprehur me dy vendime paralajmëruese, të cilat janë:

- Vendimi nr. 67, datë 14.07.2023, “*Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative, të nxjerra nga organet e disiplinës gjatë zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore, të nisur në ngarkim të Sekretarit të*

Përgjithshëm, në institucionin Autoriteti i Konkurrencës”, ku Komisioneri ka paralajmëruar institucionin e Autoritetit të Konkurrencës, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, duke vepruar në këtë mënyrë:

“Kryetari i institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, të anulojë urdhrin nr. 20, (nr. 359/1 prot.), datë 27.06.2023, “Për ngritjen e Komisionit të Disiplinës”, i ndryshuar me urdhrin nr. 23, (nr. 359/11 prot.), datë 11.07.2023, për shkak të paligjshmërisë së konstatuar në përbërje të Komisionit të Disiplinës, duke rregulluar njëkohësisht pasojat e ardhura nga ky akt.

*Komisioni i Disiplinës, të anulojë aktin nr. 359/3 prot., datë 29.06.2023, “Njoftim për fillimin e procedimit disiplinor”, ku përfshihet edhe vendimi i pezullimit nga detyra për nëpunësen *****, si dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga ky organ.”.*

- *Vendimi nr. 71, datë 25.07.2023, i Komisionerit, “Mbi përfundimin e procesit të inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative që pasqyrojnë ndryshime në ecurinë e marrëdhënies në shërbimin civil, për pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, të nxjerra nga njësia përgjegjëse dhe Komisioni i Konkurrencës, në institucionin Autoriteti i Konkurrencës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë, brenda afatit të caktuar”, ku është paralajmëruar institucioni për të rregulluar situatën e ligjshmërisë gjatë aplikimit të institutit të pezullimit në shërbimin civil, duke vepruar sipas përmbajtjes së dispozitivit të këtij vendimi.*

Në vijim të ndjekjes së procesit të zbatimit të këtyre vendimeve paralajmëruese, rezulton se:

Së pari, sa i takon zbatimit të dispozitivit të Vendimit nr. 67, datë 14.07.2023, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1002, datë 17.07.2023, “Mbi vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka vendosur ndër të tjera:

“ ...

III. Të marrë në konsideratë Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil sa i përket përbërjes së Komisionit Disiplinor.

IV. Të mos marrë në konsideratë Vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil sa i përket rekomandimeve të tjera duke i konsideruar absolutisht të pavlefshme.

V. Të ankimojë në Gjykatë vendimin nr. 67, datë 14.07.2023, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

Konstatohet se, në zbatim të Vendimit nr. 1002, datë 17.07.2023, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet Urdhrit nr. 26, (nr. 359/21 prot.), datë 18.07.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 359/1 prot., datë 27.06.2023, “Për ngritjen e Komisionit

Disiplinor”, ka urdhëruar zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, si më poshtë vijon:

- Anëtarja *****, është zëvendësuar me punonjësen ***** me detyrë “*Inspektor në Drejtorinë e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve*”;
- Anëtarja *****, është zëvendësuar me punonjësen ***** me detyrë “*Inspektor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese*”.

Gjithashtu, me Urdhrin nr. 30, (nr. 359/27 prot.), datë 26.07.2023, “*Për një ndryshim në urdhrin nr. 359/21 prot., datë 18.07.2023, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor”*”, të titullarit të institucionit, ka ndryshuar sërish përbërja e Komisionit të Disiplinës, pasi anëtari ***** është zëvendësuar me anëtarin ***** me detyrë “*Inspektor, Krye ekonomist në Drejtorinë e Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve*”.

Nga sa evidentuam më sipër, pavarësisht përpjekjes së institucionit për të rivendosur gjendjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në lidhje me përbërjen e Komisionit të Disiplinës, të ngritur në procedimin disiplinor në ngarkim të “*Sekretarit të Përgjithshëm*”, të institucionit, rezulton se, ky qëllim nuk është arritur, pasi referuar Vendimit nr. 67, datë 14.07.2023, Komisioneri ka gjetur të pa përfaqësuar në këtë organ edhe zyrtarin *në rolin e eprorit direkt të nëpunësit në procedim*, ku në mënyrë eksplicite në përmbajtje të vendimit është shprehur:

*“Së dyti, sa i takon anëtarit të Komisionit Disiplinor, i cili ka rolin e eprorit direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore me të drejtë vote, **rezulton se është i pa përfaqësuar.**”*, (paragrafi 1, faqe 7, e Vendimit nr. 67, datë 14.07.2023).

Konstatohet se, edhe pas veprimeve të ndërmarra nga titullari i institucionit për të ndryshuar përbërjen e Komisionit të Disiplinës, *zyrtari në rolin e eprorit direkt të nëpunësit në procedim rezulton ende i pa përfaqësuar* në Komision. Referuar përbërjes së Komisionit, këtë rol e luan nëpunësja ***** e emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregjeve Prodhuese*”, në Autoritetin e Konkurrencës, (*akti emërimit nr. 201/3 prot., datë 15.03.2019, i njësisë përgjegjëse*), e cila në fakt nuk mund ta gëzojë këtë tagër, edhe për shkak të nivelit të pozicionit në hierarkinë administrative të institucionit.

Në këto rrethana, për sa i përket rikthimit të ligjshmërisë në përbërjen e Komisionit të Disiplinës, konstatohet se, kjo dispozitë e vendimit të Komisionerit nuk është realizuar dhe përsëri paligjshmëria nuk është rregulluar.

Në vijim të analizës së gjithë fakteve që janë evidentuar në këtë hetim administrativ, në kushtet kur më tepër se gjysma e anëtarëve në përbërje të Komisionit të Disiplinës, i cili është krijuar me Urdhrin nr. 20, (nr. 359/1 prot.), datë 27.06.2023, i ndryshuar me Urdhrin nr. 23, (nr. 359/11 prot.), datë 11.07.2023, janë thirrur në përbërje të këtij organi në

kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, pasi nuk gëzojnë tagrin ligjor për të marrë këtë cilësi, Komisioneri në Vendimin paralajmëruar nr. 67, datë 14.07.2023 ka kërkuar që Komisioni i Disiplinës të anulojë aktet e nxjerra nga ky organ, si akte absolutisht të pavlefshme, (pika 2, e dispozitivit të Vendimit nr. 67, datë 14.07.2023).

Në këtë rast, Komisioni i Disiplinës, i ndryshuar me Urdhrin nr. 26, (nr. 359/21 prot.), datë 18.07.2023 dhe Urdhrin nr. 30, (nr. 359/27 prot.), datë 26.07.2023, të titullarit, duhet të anulonte aktet e nxjerra në kundërshtim me ligjin nga ky organ, duke nisur procedurën disiplinore nga e para, në përputhje me kërkesat e kreut X, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, fakt i cili provohet se nuk ka ndodhur.

Në këto rrethana, vlerësohet se, vendimet e marra së fundmi nga Komisioni i Disiplinës, i ndryshuar, janë në vijim të akteve të konstatuara si absolutisht të pavlefshme nga Komisioneri, ç’ka nënkupton, se aktet e mëpasshme që si bazë kanë atë që është deklaruar i pavlefshëm, i bën edhe këto akte të pavlefshme.

Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që ka lëshuar aktin, pasi ky akt konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë, ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, të cilëve iu drejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore. (Vendimi nr. 768, 12.07.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

Së dyti, sipas përmbajtjes së Vendimit nr. 1, (nr. 359/47 prot.), datë 28.09.2023, të Komisionit të Disiplinës, në paragrafin “Vlerësimi i Komisionit Disiplinor në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e *****”, të cilat përbëjnë edhe objektin e ecurisë disiplinore, konstatohet se, ka ndryshuar objekti i procedimit disiplinor, konkretisht bëhet fjalë për pikën 4 dhe pikën 5, të këtij vendimi, në të cilat janë paraqitur shkeljet e pretenduara të kryera nga nëpunësja *****; të evidentuara në informacionin e përpiluar nga nëpunësit ***** dhe *****; të shqyrtuara në mbledhjen e datës 08.09.2023, pasqyruar në procesverbalin nr. 359/38 prot. të së njëjtës datë.

Në rastin konkret, kemi ndryshim të objektit, për të cilin ka nisur ecuria disiplinore në ngarkim të nëpunëses *****; fakt për të cilin kjo nëpunëse nuk është njoftuar nga ana e Komisionit Disiplinor.

Komisioni Disiplinor në këtë rast, ka bërë ndryshim të objektit të ecurisë disiplinore, pasi referuar pikës 14, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, ky organ disiplinor ka të drejtë të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Por, në respektim të pikës 15, të këtij akti nënligjor, Komisioni i Disiplinës

ka detyrim ligjor t'i vendosë në dispozicion nëpunësit që po procedohet materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi, veprim i cili nuk provohet të jetë kryer nga ky organ, duke i mohuar të drejtën për t'u njohur me ndryshimin e objektit të ecurisë disiplinore në ngarkim të tij dhe rrjedhimisht me të drejtën për t'u mbrojtur.

Së treti, nga ana e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, Vendimet paralajmëruese të nxjerra nga Komisioneri, janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe janë ende në pritje për t'u gjykuar nga ana e gjykatës.

Në të këto rrethana, vlerësohet se, në zbatim të paragrafit 3, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i cili sanksionon se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, Komisioneri vlerëson se, në këtë rast ecuria disiplinore në ngarkim të nëpunëses ******, me detyrë ish *“Sekretar i Përgjithshëm”*, pranë institucionit të Autoritetit të Konkurrencës duhej të ndërpritej, derisa gjykata si një organ mbi palët të shprehej dhe rasti në fjalë të zgjidhej midis palëve sipas vendimit përfundimtar që do të jepte gjykata.

Për gjithë sa u evidentuan më sipër, arrijmë në konkluzionin se, Komisioni Disiplinor i ngritur me urdhrin nr. 20, (nr. 359/1 prot.), datë 27.06.2023, i ndryshuar, të titullarit të institucionit ka vepruar në kundërshtim flagrant me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe procedurale; në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”*, si dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, sa i përket aspektit procedural të zhvillimit të procedurës së ecurisë disiplinore.

Në këto rrethana, referuar gërmës a), të nenit 108, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, vijimi i procesit të ecurisë disiplinore vlerësohet si një proces administrativ i pavlefshëm dhe për pasojë organet që kanë nxjerrë aktet administrative në përmbajtje të tij, si titullari i institucionit dhe Komisioni i Disiplinës, me qëllim që të rregullojnë ligjshmërinë duhet që ti konstatojnë si të tilla dhe t'i anulojnë ato, në zbatim të nenit 110 dhe 111, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të rregullojnë pasojat.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të neneve 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, *“Për Mbrojtjen e Konkurrencës”*; të Vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Autoritetit të Konkurrencës për rregullimin e situatës së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të kërkesave të ligjore ashtu si është pasqyruar në përmbajtjen e këtij vendimi duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Komisioni i Disiplinës, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të Vendimit nr. 1, (nr. 359/47 prot.), datë 28.09.2023, me të cilin ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësen *****, si dhe çdo akt tjetër të nxjerrë nga ky organ disiplinor.
2. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 5 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
3. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar aktet përkatëse që materializojnë ekzekutimin e tij.
4. Të njoftohet për këtë vendim Autoriteti i Konkurrencës dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha